



23-10-2021

Prishtinë / Priština

2815-2021

Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63, paragrafi 4 dhe neni 54 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe nenin 4, paragrafi 2 të Rregullës Zgjedhore nr.10/2013, Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 23.10.2021, merr këtë:

## VENDIM

### Për distinktivët e vëzhguesve të subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare vendore të Zgjedhjeve Lokale të 17 tetorit 2021

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për anulimin e distinktivëve të vëzhguesve të subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare vendore të zgjedhjeve lokale të mbajtura me datë 17 tetor 2021.
- II. Distinktivët e Raundit të Parë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datë 17 tetor 2021, të subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare vendore vlejné vetëm për qasje në Qendrën e Numërimeve dhe Rezultateve dhe atë deri në certifikimin e rezultatet për kuvendet komunale.
- III. Distinktivët e Raundit të Parë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datë 17 tetor 2021, të subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare vendore, nuk mund të përdorën për t'u qasur në qendra dhe vendvotime ku organizohet Raundi i Dytë i Zgjedhjeve.
- IV. Distinktivët e Raundit të Dytë të Zgjedhjeve Lokale, të subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare vendore, do të kenë ngjyrë dhe përshkrim të ndryshëm nga ato të Raundit të Parë të Zgjedhjeve Lokale.
- V. Obligohet Zyra për zbatimin e këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Me këtë vendim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve eliminon mundësinë e keqpërdorimit të distinktivëve të vëzhguesve të subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare të cilët janë të pajisur më distinktivë në zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021.

Subjektet Politike dhe OJQ-të vendore për tu pajisur më distinktivë për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave që do të mbahen me datë 14 nëntor 2021, duhet të konfirmojné listat e vëzhguesve deri më datën 08 nëntor 2021. Andaj bazuar në këto që u thanë më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi, Kryesues

